



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 258, Datë 02.12.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“MER ENERGJI” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2410/1prot., datë 21.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2410 prot., datë 18.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Faqekuq 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në Fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 2.1 gërma “a”.
- Rezulton se shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k.:
  - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) “Për ndërtimin e Hidrocentralit “Faqekuq III” nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, si dhe Kontratën Shtesë të Koncesionit nr. 15 rep., nr. 9 kol., datë 07.10.2022.
  - Ka depozituar shkresën e shoqërisë së “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. me nr. 216/3 prot., datë 12.01.2022, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes.

- Ka depozituar në ERE Vendimin nr. 2, datë 03.10.2022 “Për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik shoqërisë “MER ENERGI” sh.p.k.” të Këshillit të Basenit Ujq Seman, si dhe Lejen për përdorimin e Burimit Ujq sipërfaqësor nr. 746 prot., datë 10.10.2022, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujq (KBU) Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është sipas kontratës së koncesionit.
  - Ka depozituar Vendimin për VNM Paraprake, lëshuar më 24.03.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC Faqekuq 3, me fuqi të instaluar 1300 kW. Kjo VNM parashikonte që shoqëria duhet të fillonte zbatimin në terren të projektit dhe fillimin e punimeve brenda datës 24.03.2024. Duke qenë se shoqëria nuk ka depozituar informacion në lidhje me fillimin e punimeve brenda kësaj date, vlerësohet t’i kërkohet ky informacion. Nëse shoqëria nuk ka filluar punimet e ndërtimit, duhet të depozitohet në ERE një VNM Paraprake të re.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka depozituar në format fotokopje dokumentet e mëposhtme, ndaj në zbatim të nenit 8, pikës 3 të Rregullores, duhet të depozitohet në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin dokumentat në vijim:
- *Planin e biznesit;*
  - *Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, së bashku me Kontratën Shtesë të Koncesionit nr. 15 rep., nr. 9 kol., datë 07.10.2022;*
  - *Shkresën e “OSSH” sh.a me nr. 216/3 prot., datë 12.01.2022;*
  - *Vendimin nr. 2, datë 03.10.2022 të KBU Seman dhe Lejen për përdorimin e Burimit Ujq sipërfaqësor nr. 746 prot., datë 10.10.2022.*
- Po ashtu nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si më poshtë vijon:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

##### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitohet në ERE vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për administratorin e saj.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitohet strukturën organizative të saj

##### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitohet në ERE vërtetimin në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke iu referuar periudhës deri në momentin e aplikimit në ERE.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitohet dokumentacionin vërtetues të aftësinë financiare për realizimin e plotë të investimit, referuar mënyrës së financimit.

- Përveç sa më sipër, vlerësohet që shoqëria të depozitohet informacion në lidhje me zbatimin nga ana e saj të afateve për ndërtimin e centralit, sikurse përcaktuar në Kontratën nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, e ndryshuar, e nënshkruar me MIE-n.



a më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

jë procedurën për licencimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Façekuqi 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në Fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “MER ENERGJI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**